



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 3, Datë 11.04.2017

Për

Dhënien e Lejes për Mbushjen me Ujë për Herë të Parë të rezervuarit dhe Vënien në Ngarkesë të Digës “Ura e Fanit”.

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 8, 1.3, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 11.04.2017, mori në shqyrtim kërkesen e Kompanisë Ayen As Energji sh a për dhënien e Lejes të Mbushjes për Herë të Parë, sipas shkresës nr. 072 datë 07.04.2017, si dhe Akt-Kolaudimit të punimeve të digës “Ura e Fanit”, të përgatitura nga Prof. Dr. Ing. Milahim Dokle.

Objektet kryesore të kësaj vepre janë :

- Diga me mbushje me gurë dhe ekran beton arme me lartësi 92.0 m.
- Skarpatat e digës janë 1:1.5. Mbi kurorë ka një parapet beton arme me lartësi 2.0 m.
- Shkarkuesi sipërfaqësor komandohet nga 4 porta metalike me përmasa 9x7.5m.
- Tuneli i devijimit me gjatësi 413 m dhe diametër 7.4 m. Brënda këtij tuneli vëndoset tubacioni i shkarkuesit fundor me diametër 2.0 m.
- Tuneli derivacionit me presion me gjatësi 9.6 km dhe diametër të brëndshëm 6.0 m.
- Ndërtesa e Centralit e vëndosur në afërsi të fshatit Fang të rrethit të Mirditës.

- Niveli normal i ujit në kuotën 165.00m
- Volumi i ujit në rezervuar është 165 milion m³.
- Në digë është vëndosur sistemi i aparaturave te monitorimit qe do të japin të dhëna për gjëndjen e digës gjatë ngarkimit dhe në shfrytëzim.

Nga dokumentacioni i paraqitur në Aktin e Kolaudimit rezulton qe nuk jane bere ndryshime nga projekti i miratuar.

KKDM, mbas paraqitjes së dokumentacionit të Aktit të Kolaudimit nga Prof. Dr. ing Milahim Dokle, si dhe paraqitjes së mendimit të Këshillit Teknik nga ing Dhimiter Vogli si dhe mbas diskutimeve,

VENDOSI:

Të miratojë Akt Kolaudimin dhe të japë Lejen për Mbushjen me Uje për Herë të Parë të rezervuarit dhe vënien në ngarkesë të digës “ Ura e Fanit”, duke mbajtur parasysh dhe në zbatim sa vijon :

1. Kompania AYEN AS ENERGJI SH A para fillimit të procedurave të mbushjes me ujë të njoftojë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Punëve Brëndshme, Ministrinë e Bujqesisë, si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor në rajonin e ndërtimit të digës. (Neni 25.pika 2,4 e VKM 147 datë 18 .03.2004).
2. Gjatë mbushjes së ujëmbledhësit të kryhet mbikqyrja e gjithë objekteve të veprës dhe të veprohet në zbatim të Planit të Mbushjes me Ujë për Herë të Parë.
3. Të vrojtohen fenomenet artificiale sizmike që mund të krijohen nga mbushja me ujë, si dhe lidhja e tyre me objektet, duke mbajtur në vrojtim të gjitha aparaturat e tjera të monitorimit.
4. I rekomandojme kompanisë AYEN AS ENERGJI SH A të kontaktojë me IGJEUM, për të krijuar mundësinë e lidhjes në rrjet te të dhënave sizmike.
5. Kompania AYEN AS ENERGJI SH A të përgatisë dhe të dorzojë në KKDM Akt Kolaudimin përfundimtar i cili do të hartohet mbas vënies në ngarkesë të plotë të objektit.

6. Me raportin 6 mujor (në fund të vitit 2017) Kompania AYEN AS ENERGJI SH A të dorzojë në KKDM “Rregulloren Teknike të Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Kontrollit të Objekteve”. Një kopje e kësaj rregullorje të dorzohet në Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë.

Ing. Maksim Muci

KRYETAR

